



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 374/8 Prot.

Tiranë, më 30.05.2023

V E N D I M

Nr. 78, Datë 30.05.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 41, datë 08.03.2023, e bërë nga znj. H.Ç, e përfaqësuar me deklaratë nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në të cilën pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”, nga linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Lushnjë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datë 26.02.2023, në orën 11.00, po udhëtoja në linjën e transportit publik nga Durrësi (Plepa) për në Lushnjë. Gjatë rrugës fatorino kërkoi lekët. Unë i paraqita librezën e verbërisë për të paguar gjysmë bilete, por fatorino më imponoi që ti jepja lekët për biletë të plotë. Linja e transportit ishte Tiranë-Lushnjë, por nuk arrita të merrja targën e mjetit, pasi nuk më ndihmoi njeri për ta filmuar”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e kompanisë së transportit ndërurban, për shkak të aftësisë së kufizuar.

¹ Referuar Librezës nr. 00904 të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, znj. H.Ç është e verbër Grupi I (parë).

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin, i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë-Lushnje dhe mjetin me të cilin kishte udhëtuar në datë 26.02.2023, ditë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 374/1, datë 20.03.2023, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Me shkresën nr. 5511/1, datë 28.03.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe në platformën elektronike eTransport, rezulton se në itinerarin e transportit ndërqytetës Tiranë-Lushnje dhe orarin e përmendur, është licencuar për operim shoqëria e transportit “.....” shpk”.*

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 374/3, datë 03.04.2023, ka kërkuar informacion nga Shoqëria “.....” shpk, lidhur me pretendimin e ngritur në ankesë.

Me shkresën nr. 01/23, datë 12.04.2023, Shoqëria “.....”, shpk, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga pyetja e të gjithë personelit, shofer dhe fatorino ata konfirmuan faktin se për shërbimin e transportit në linjën ndërqytetëse Tiranë-Lushnje-Tiranë, autobusët e linjës nuk kalojnë dhe nuk ndalojnë për të marrë apo zbritur pasagjerë në vendin Plepat (Durrës). Pra, të gjithë autobusët e linjave që nisen nga Tirana për në qytetet e Jugut e kanë të ndaluar të kalojnë dhe ndalojnë në vendin Plepa, pasi nuk është stacion ndalimi i miratuar nga Bashkia Durrës dhe nga DPSHTRR, për mjetet e linjave ndërqytetëse, për të zbritur dhe marrë pasagjerë. Kjo zonë është e mbikëqyrur nga policia rrugore dhe ndalesa nga shoferët në këtë vend bëhet shkak për marrjen e masave ndëshkuese ndaj tyre si, gjoha dhe masa të tjera administrative. Pra, nga paraqitja e fakteve më sipër mendojmë se subjekti ankues mundet të ketë hipur në mjetet mikrobus apo autobus në një nga linjat Durrës-Lushnje.*

Nisur nga fakti se në shumë raste nga udhëtarët e kategorive me aftësi të kufizuar janë paraqitur pranë fatorinove dokumentacion fotokopje e pa noterizuar të Librezave, Dëshmime, Vendimeve të KMCAP, etj, u vendos që nëpërmjet kësaj shkrese dhe mjeteve të tjera të informimit tu bëhet e ditur Shoqatave dhe Organizatave të ndryshme se në çdo rast udhëtimi nga personat me aftësi të kufizuar do tu njihen dhe pranohen si dokumentacion të vlefshme udhëtimi, vetëm ato që përcakton ligji për ta, për secilën kategori, dokumentacion origjinal ose fotokopje të noterizuar, në mënyrë që të përfitojnë lehtësirat financiare përkatëse gjatë udhëtimit”.

- Në vijim të trajtimit të ankesës, lidhur me identifikimin e subjektit që ofron shërbimin e transportit në linjën Durrës-Lushnje, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 374/5, datë 18.04.2023, i është drejtuar përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. 7325/1, datë 20.04.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe në platformën elektronike eTransport, rezulton se në periudhën e muajit shkurt 2023 në linjën e rregullt të transportit të udhëtarëve Durrës-Lushnje-Durrës, nuk ka pasur subjekt të licencuar për operim”.*

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar nga institucionet dhe subjektet, informacionin e nevojshëm, lidhur me rastin e pretenduar nga ankuesja, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat për identifikimin e subjektit që pretendohet të ketë kryer veprimin diskriminues, duke komunikuar me DPSHTRR dhe me subjektin që është i licencuar për transportin e udhëtarëve në linjën Tiranë-Lushnje. Në përgjigjen e dhënë nga subjekti “.....” shpk, rezulton se autobusët e kësaj shoqërie që përshkojnë linjën Tiranë-Lushnje, nuk kalojnë në vendin Plepat (Durrës), pasi nuk është stacion ndalimi i miratuar nga Bashkia Durrës dhe nga DPSHTRR, për mjetet e linjave ndërqytetëse.

Në kushtet kur, nuk identifikohet subjekti që pretendohet se ka kryer veprimin diskriminues, Komisioneri vlerëson se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim të mëtejshëm, lidhur me ankesën e znj. H.Ç.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”,* Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga znj. H.Ç, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA